



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.72

26 maj

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.521, datë 23.4.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Bytyç, të qarkut të Kukësit.....	3147
Vendim i KM nr.522, datë 23.4.2008	Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të mjeteve motorike.....	3156
Vendim i KM nr.524, datë 23.4.2008	Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Maldivëve.....	3168
Vendim i KM nr.525, datë 23.4.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.666, datë 26.10.1998 të Këshillit të Ministrave “Për disa masa lidhur me procesin e likuidimit të ndërmarrjeve të varësisë së ish-Agjencisë Qendrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore, të ndryshuar	3168
Vendim i KM nr.526, datë 23.4.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “LNK” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Sllabinjë”.....	3169
Vendim i KM nr.527, datë 23.4.2008	Për disa shtesa në vendimin nr.512, datë 31.5.2006 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve shoqërore”	3180
Vendim i KM nr.533, datë 1.5.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Ersekë të qarkut të Korçës.....	3181

Vendim i KM nr.534, datë 1.5.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajjtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Udenisht të qarkut të Korçës	3182
Vendim i KM nr.535, datë 1.5.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajjtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Përrenjas të qarkut të Elbasanit.....	3183
Vendim i KM nr.536, datë 1.5.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajjtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Durrës të qarkut të Durrësit	3184
Vendim i KM nr.538, datë 1.5.2008	Për përcaktimin e pajisjeve të veçanta, të ngjyrave dhe shenjave për mjetet e Policisë së Shtetit.....	3185

VENDIM
Nr.521, datë 23.4.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA BYTYÇ, TË QARKUT TË KUKËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Bytyç, të qarkut të Kukësit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 7 (shtatë) fletë, që përfundon me numrin rendor 214 (dyqind e katërmëdhjetë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Bytyç për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËRORE

(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave										
Komuna: Bytyç										
Fusha e përdorimit të pronës: pyje, kullota etj.										
Nr. rend	Nr. inv. sipas VKM	Emërtesa e Ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK)	Emërtesa e ngastrës vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësitë administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	121	Berishe - Bytyç	Podi i Gurit Zi	3b	Pyll Mbrojtes	6.5	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
2	122	Berishe - Bytyç	Podi i Gurit Zi	3c	Pyll Prodhues	15.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
3	125	Berishe - Bytyç	Poshte Visoçe	4c	Pyll Mbrojtes	16	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
4	127	Berishe - Bytyç	Poshte Visoçe	5b	Pyll Prodhues	16.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
5	130	Berishe - Bytyç	Lisi i Zogut	6c	Pyll Prodhues	4.5	LP+Dr Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
6	131	Berishe - Bytyç	Lura	7	Pyll Prodhues	22.25	LP+Dr Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
7	140	Berishe - Bytyç	Guri i Gjate	11a	Pyll Prodhues	30.25	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
8	147	Berishe - Bytyç	Poshte Zukes Visoç	14a	Pyll Prodhues	3.85	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
9	148	Berishe - Bytyç	Poshte Zukes Visoç	14b	Pyll Prodhues	9.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
10	150	Berishe - Bytyç	Mbi Sht.Man Avdise	15	Pyll Prodhues	8	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
11	151	Berishe - Bytyç	Poshte Zukes Vsoç	16a	Pyll Prodhues	5.5	LP+Dr Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
12	168	Berishe - Bytyç	Krenat e Belinjehit	24b	Pyll Prodhues	13.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
13	169	Berishe - Bytyç	Krenat e Belinjehit	25a	Pyll Prodhues	19.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
14	171	Berishe - Bytyç	Shpati i Muses	27b	Pyll Prodhues	7.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
15	172	Berishe - Bytyç	Kreja Shpatit Muses	28	Pyll Prodhues	5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
16	173	Berishe - Bytyç	Qafa e Saraçinit	29a	Pyll Prodhues	15	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
17	174	Berishe - Bytyç	Qafa e Saraçinit	29b	Livadh	3.5	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
18	175	Berishe - Bytyç	Ara e Tomes	30a	Pyll Prodhues	10.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
19	178	Berishe - Bytyç	Prrockat e Krrabit	31	Pyll Prodhues	15	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
20	185	Berishe - Bytyç	Kodra e Totqise	35a	Pyll Prodhues	29.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
21	197	Berishe - Bytyç	Prroi Pirres Rushte	44	Pyll Prodhues	20.75	LP+Dr Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
22	198	Berishe - Bytyç	Kodra e Permices	45	Shkurre Mbroj.	20	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	

23	199	Berishe - Bytyç	Kodra e Permices	46	Pyll Prodhues	27.25	LP+Dr Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
24	208	Berishe - Bytyç	Poshte Ares Sukes	52	Pyll Prodhues	10.5	LP+Dr Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
25	209	Berishe - Bytyç	Hamallat e Avdylit	53a	Pyll Prodhues	22.5	LP+Dr Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
26	210	Berishe - Bytyç	Hamallat e Avdylit	53b	Pyll Prodhues	6.75	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
27	212	Berishe - Bytyç	Hamallat e Avdylit	54a	Pyll Prodhues	23.75	LP+Dr Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
28	213	Berishe - Bytyç	Hamallat e Avdylit	54b	Sip.Inproduk	40		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
29	233	Berishe - Bytyç	Poshte Firajave	60d	Livadh	0.5	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
30	239	Berishe - Bytyç	Poshte Br.Isuf Ukes	63d	Livadh	0.5	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
31	244	Berishe - Bytyç	Poshte Br.Isuf Ukes	65b	Kullote	23.5	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
32	274	Berishe - Bytyç	Kthesa e prroit Thelle	80	Shkurre Mbroj.	16	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
33	278	Berishe - Bytyç	Ku behet uji Gur	81d	Livadh	1.5	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
34	279	Berishe - Bytyç	Çitolla	82a	Pyll Prodhues	10	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
35	280	Berishe - Bytyç	Arat e Brahes	82b	Pyll Prodhues	12.35	LP+Dr Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
36	286	Berishe - Bytyç	Poshte Livadhit guges	86b	Pyll Prodhues	2	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
37	293	Berishe - Bytyç	Arat e Rrahit	93	Pyll Prodhues	9.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
38	294	Berishe - Bytyç	Mrizat	94	Pyll Prodhues	13.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
39	296	Berishe - Bytyç	Prroi I Gjures	95b	Pyll Prodhues	20.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
40	297	Berishe - Bytyç	Shpati Kodres Kajes	96	Pyll Prodhues	18	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
41	298	Berishe - Bytyç	Kodra e Kajes	97	Pyll Prodhues	22	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
42	299	Berishe - Bytyç	Kopshti I B.Mehmetit	98a	Pyll Prodhues	6	LP+Dr Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
43	300	Berishe - Bytyç	Kopshti I B.Mehmetit	98b	Pyll Prodhues	10	LP+Dr Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
44	319	Berishe - Bytyç	Kolshani	108c	Pyll Prodhues	11.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
45	337	Berishe - Bytyç	Kurmat	116a	Pyll Prodhues	15	LP+Dr Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
46	341	Berishe - Bytyç	Pirrat e Nevadit	118a	Shkurre Mbroj.	22	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
47	342	Berishe - Bytyç	Pirrat e Nevadit	119	Shkurre Mbroj.	27	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
48	346	Berishe - Bytyç	Podi I Mihajve	122a	Pyll Prodhues	17	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
49	347	Berishe - Bytyç	Podi I Mihajve	122b	Sip.Inproduk	1		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
50	348	Berishe - Bytyç	P.Varrezave Çorroit	123	Shkurre	11.5	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
51	349	Berishe - Bytyç	Gugajt	124a	Pyll Prodhues	30	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
52	350	Berishe - Bytyç	Gugajt	124b	Livadh	1	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
53	351	Berishe - Bytyç	Mbi Çitolla	125	Pyll Prodhues	25	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	

54	352	Berishe - Bytyç	Mbi Ali Hasanin	126	Pyll Prodhues	17.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
55	369	Berishe - Bytyç	Mali I Mehmetit	134b	Pyll Prodhues	25	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
56	371	Berishe - Bytyç	Boga e Mashit	135	Pyll Prodhues	14.75	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
57	373	Berishe - Bytyç	Boga e Shplume	136b	Kullote	14	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
58	379	Berishe - Bytyç	Shpati I Livadheve	139a	Pyll Prodhues	28	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
59	404	Berishe - Bytyç	Mbi stanet e Deges	154b	Kullote	15	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
60	440	Berishe - Bytyç	Lugu I Lares	174a	Pyll Prodhues	9.75	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
61	442	Berishe - Bytyç	Gurthi	175a	Pyll Prodhues	11.5	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
62	444	Berishe - Bytyç	Thpati I Rogave	176a	Pyll Prodhues	36	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
63	448	Berishe - Bytyç	Gomuri I Kodres	179a	Pyll Prodhues	18	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
64	450	Berishe - Bytyç	Shullani I Ahmetit	180a	Pyll Prodhues	19	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
65	452	Berishe - Bytyç	Hardhishte	181a	Pyll Prodhues	35.75	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
66	454	Berishe - Bytyç	Hardhishte	182a	Pyll Prodhues	30	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
67	455	Berishe - Bytyç	Hardhishte	182b	Kullote	3.5	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
68	470	Berishe - Bytyç	Q.Madhe e Nevadit	190a	Pyll Prodhues	8.5	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
69	471	Berishe - Bytyç	Q.Vogel e Nevadit	190b	Shkurre	19.25	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
70	472	Berishe - Bytyç	Q.Vogel e Nevadit	191	Shkurre	35	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
71	488	Berishe - Bytyç	Shpati I Bregut Vladit	198a	Pyll Prodhues	4.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
72	489	Berishe - Bytyç	Shpati I Bregut Vladit	198b	Pyll Prodhues	12	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
73	517	Berishe - Bytyç	Shpati I Tutajve	214a	Pyll Prodhues	29	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
74	518	Berishe - Bytyç	Shpati I Tutajve	214b	Kullote	3	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
75	519	Berishe - Bytyç	Shpati I Tutajve	215	Shkurre	14.5	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
76	520	Berishe - Bytyç	Rrongaja	216a	Pyll Prodhues	14.25	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
77	521	Berishe - Bytyç	Rrongaja	216b	Pyll Prodhues	17.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
78	522	Berishe - Bytyç	Mbi Sht.Baram Ukes	217	Pyll Prodhues	20.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
79	526	Berishe - Bytyç	Shpati I Rrangajave	219a	Pyll Prodhues	7.25	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
80	529	Berishe - Bytyç	Shpati I Demaliajve	220a	Pyll Prodhues	2	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
81	530	Berishe - Bytyç	Shpati I Demaliajve	220b	Pyll Prodhues	3.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
82	531	Berishe - Bytyç	Shpati I Demaliajve	220c	Sip.Inproduk	18		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
83	532	Berishe - Bytyç	Shpati I Demaliajve	221a	Pyll Prodhues	4	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
84	533	Berishe - Bytyç	Shpati I Demaliajve	221b	Pyll Prodhues	26	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
85	534	Berishe - Bytyç	Shpati I Nezajve	222a	Sip.Inproduk	10.25		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	

86	535	Berishe - Bytyç	Shpati I Zhives	222b	Sip.Inproduk	17	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
87	536	Berishe - Bytyç	Shpati I Sinanajve	223	Pyll Prodhues	40.25	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
88	543	Berishe - Bytyç	Lugu I Qytezes	228	Sip.Inproduk	16	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
89	544	Berishe - Bytyç	Shpati Rezer.Vladit	229	Pyll Prodhues	17.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
90	545	Berishe - Bytyç	Shpati Rezer.Vladit	230	Pyll Prodhues	17.25	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
91	561	Berishe - Bytyç	Shpati Rezer.Vladit	239b	Kullote	23	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
92	562	Berishe - Bytyç	Shpati Rezer.Vladit	240a	Pyll Prodhues	4	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
93	563	Berishe - Bytyç	Shpati Rezer.Vladit	240b	Kullote	25	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
94	569	Berishe - Bytyç	Shpati I Majes Dhine	246	Kullote	40	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
95	570	Berishe - Bytyç	Gershinze e Vladit	247	Kullote	37.25	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
96	571	Berishe - Bytyç	Lugina Qafes Cukut	248	Kullote	31	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
97	572	Berishe - Bytyç	Shpati Lakut Çekrezit	249a	Pyll Prodhues	6.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
98	575	Berishe - Bytyç	Kuçovza	251a	Pyll Prodhues	12	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
99	576	Berishe - Bytyç	Kuçovza	251b	Kullote	3	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
100	586	Berishe - Bytyç	Arat e Hysenajt	260a	Pyll Prodhues	4	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
101	587	Berishe - Bytyç	Shpati I Liv.Cenajve	260b	Shkurre	48	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
102	601	Berishe - Bytyç	Shpat Fushes Shkurter	268	Shkurre	34.75	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
103	602	Berishe - Bytyç	Shpati Lugut Madhe	269	Shkurre	68.75	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
104	603	Berishe - Bytyç	Shpati Ibrahim Jakupit	270a	Shkurre	53.75	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
105	609	Berishe - Bytyç	Shpati Kodres Çorraje	273a	Pyll Prodhues	61	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
106	611	Berishe - Bytyç	Kurrizi Kriot Nezirit	274a	Shkurre	34.5	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
107	620	Berishe - Bytyç	Lenzat e Epra	281a	Pyll Prodhues	43.75	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
108	621	Berishe - Bytyç	Lenzat	281b	Kullote	4.5	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
109	622	Berishe - Bytyç	Shpati mbi Kam	282a	Pyll Prodhues	29.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
110	626	Berishe - Bytyç	Shpati I Shullanit	284a	Pyll Prodhues	9.25	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
111	628	Berishe - Bytyç	Prroi I Lugut te Kamit	285a	Pyll Prodhues	7	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
112	630	Berishe - Bytyç	Shpati Prroit Kamit	286	Shkurre	52	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
113	631	Berishe - Bytyç	Shpati mbi baraken e Kamit	287	Shkurre	47	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
114	637	Berishe - Bytyç	Kam	293	Shkurre	45.25	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
115	642	Berishe - Bytyç	Shpati I Kamit	296	Shkurre	21	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	

116	645	Berishe - Bytyç	Shpati I Prr.Skatines	298a	Sip.Inproduk	24		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
117	646	Berishe - Bytyç	Projet e Kamit	298b	Sip.Inproduk	7.25		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
118	647	Berishe - Bytyç	Shpati I Prr.Skatines	299	Sip.Inproduk	21.5		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
119	651	Berishe - Bytyç	Lugina e Kroit Gulles	303	Sip.Inproduk	30		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
120	670	Berishe - Bytyç	Shpati I Gurit Cekit	313a	Pyll Prodhues	10	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
121	671	Berishe - Bytyç	Rrahi I Baramit	314	Shkurre	17.25	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
122	672	Berishe - Bytyç	Bregu I ProckesThate	315	Shkurre	27	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
123	673	Berishe - Bytyç	Hurdhat Hasan Osmanit	316a	Pyll Prodhues	9.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
124	674	Berishe - Bytyç	Hurdhat Hasan Osmanit	316b	Pyll Prodhues	14	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
125	675	Berishe - Bytyç	Rrahi I Hysenit	316c	Livadh	2.5	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
126	676	Berishe - Bytyç	Karma e Leniqit	317a	Pyll Prodhues	14	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
127	677	Berishe - Bytyç	Karma e Leniqit	317b	Pyll Prodhues	12	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
128	678	Berishe - Bytyç	Shpati I Sukes Pesdost	318a	Pyll Prodhues	13.5	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
129	679	Berishe - Bytyç	Laki I Majes Qytetit	318b	Pyll Prodhues	8	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
130	680	Berishe - Bytyç	Shpati I Sukes Pesdost	318c	Pyll Prodhues	15.5	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
131	681	Berishe - Bytyç	Shpati I Sukes Pesdost	318d	Pyll Prodhues	5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
132	689	Stoberde	Stoberde	1	Kullote	32.25	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
133	690	Stoberde	Stoberde	2	Kullote	16.5	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
134	691	Stoberde	Stoberde	3	Kullote	14	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
135	692	Stoberde	Stoberde	4	Kullote	20	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
136	693	Stoberde	Stoberde	5	Kullote	19.75	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
137	694	Stoberde	Stoberde	6	Kullote	13.5	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
138	695	Stoberde	Stoberde	7	Kullote	27.75	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
139	696	Stoberde	Stoberde	8	Kullote	29	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
140	697	Stoberde	Stoberde	9	Kullote	8.5	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
141	698	Stoberde	Stoberde	10	Kullote	8.25	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
142	701	Stoberde	Shpati I Zherkes	11c	Sip.Boshe	11		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
143	704	Stoberde	Shpati I Zherkes	12c	Sip.Boshe	4.5		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
144	706	Stoberde	Shpati I Rezervarit	13b	Kullote	9.5	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
145	707	Stoberde	Shpati I Rezervarit	16	Kullote	55	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	

146	709	Stoberde	Kurrizi Rezervarir	17b	Sip.Boshe	13.75		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
147	711	Stoberde	Kurrizi Rezervarir	18b	Sip.Boshe	19		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
148	713	Stoberde	Kunji I Tregut	19b	Pyll Prodhues	4.25	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
149	715	Stoberde	Kunji I Tregut	19d	Sip.Boshe	7.5		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
150	720	Stoberde	Ahishta e Stoberdes	21a	Pyll Prodhues	3.75	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
151	721	Stoberde	Maja e Stoberdes	21c	Pyll Prodhues	9.5	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
152	726	Stoberde	Lugu I Bales	24b	Sip.Boshe	2.25		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
153	728	Stoberde	Lugu I Bales	25b	Sip.Boshe	4		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
154	731	Stoberde	Lugu I Bales	26b	Sip.Boshe	4.75		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
155	734	Stoberde	Lugu I Bales	27b	Sip.Boshe	2.5		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
156	736	Stoberde	Kodra e Muharremi	30b	Sip.Boshe	17.75		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
157	740	Stoberde	Lugjet e Bales	29b	Sip.Boshe	20.5		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
158	741	Stoberde	Dejc	31a	Pyll Prodhues	5	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
159	742	Stoberde	Dejc	31c	Pyll Prodhues	22	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
160	744	Stoberde	Dejc	32b	Sip.Boshe	2.75		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
161	749	Stoberde	Shpati I Luges Vishives	34b	Sip.Çveshur	13		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
162	751	Stoberde	Lugu I Vishives	35b	Sip.Çveshur	7.75		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
163	752	Stoberde	Maja e Lajthizes	36a	Pyll Prodhues	20	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
164	753	Stoberde	Maja e Lajthizes	36b	Sip.Çveshur	17.25		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
165	757	Stoberde	Shpati I Mehmet Alise	37c	Pyll Prodhues	10.5	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
166	759	Stoberde	Maja e Lajthizes	38b	Sip.Çveshur	2.5		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
167	761	Stoberde	Faqja e Majes Lajthizes	39b	Kullote	33.25	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
168	762	Stoberde	Kodra e Dejcit	40a	Pyll Prodhues	18.5	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
169	763	Stoberde	Kodra e Dejcit	40b	Sip.Çveshur	2.75		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
170	768	Stoberde	Shpati I Lejthizes	43b	Pyll Prodhues	18.75	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
171	769	Stoberde	Shpati I Lejthizes	43c	Sip.Çveshur	12		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
172	771	Stoberde	Maja e Fushave	44b	Sip.Çveshur	25.25		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
173	773	Stoberde	Kroi I Petrocit	45b	Sip.Çveshur	8		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
174	774	Stoberde	Ashta e Petrocit	45c	Pyll Prodhues	15	L.P. + D.zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
175	776	Stoberde	Prrocka e Lajthizes	46b	Sip.Çveshur	20.75		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
176	778	Stoberde	Lugu I Druve	47b	Sip.Çveshur	14.5		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
177	779	Stoberde	Lugu I Druve	47c	Pyll Prodhues	41.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	

178	781	Stoberde	Stanet e Kamit	48b	Sip.Çveshur	15		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
179	785	Stoberde	Kodra e Kamit	50b	Sip.Çveshur	27.5		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
180	786	Stoberde	Gjanat e Kepenekut	51a	Pyll Prodhues	30	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
181	787	Stoberde	Gjanat e Kepenekut	51b	Pyll Mbrojtes	55.75	Mrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
182	790	Stoberde	Varrezat e kepenekut	54	Pyll Mbrojtes	55	Mrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
183	791	Stoberde	Shatinat e Kepenekut	55	Pyll Mbrojtes	38.25	Mrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
184	794	Stoberde	Shatinat e Kepenekut	58	Pyll Mbrojtes	38.5	Mrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
185	795	Stoberde	Shatinat e Kepenekut	59	Pyll Mbrojtes	43.25	Mrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
186	803	Stoberde	Kepenek	67b	Pyll Mbrojtes	30.5	Mrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
187	812	Stoberde	Shpati Mahalle Eper	77a	Pyll Prodhues	40.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
188	813	Stoberde	Shpati Mahalle Eper	77b	Sip,Boshe	21.5		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
189	814	Stoberde	Shpati Mahalle Eper	78a	Pyll Prodhues	25	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
190	815	Stoberde	Shpati Mahalle Eper	78b	Sip,Boshe	23		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
191	819	Stoberde	Shpati I Zogajve	82	Pyll Prodhues	28.75	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
192	821	Stoberde	Shpati I Zogajve	84	Kullote	26	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
193	822	Stoberde	Lugu I Oplasit	85a	Pyll Prodhues	7.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
194	823	Stoberde	Lugu I Oplasit	85b	Sip.Çveshur	5.5		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
195	824	Stoberde	Lugu I Oplasit	85c	Pyll Prodhues	8	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
196	826	Stoberde	Shpati I Zogajve	87	Pyll Mbrojtes	20.75	Mrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
197	827	Stoberde	Shpati I Zogajve	88	Pyll Prodhues	19.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
198	828	Stoberde	Shpati I Mjekrrbardhit	89	Pyll Mbrojtes	29.25	Mrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
199	829	Stoberde	Shpati I Mjekrrbardhit	90a	Pyll Prodhues	7	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
200	830	Stoberde	Shpati I Mjekrrbardhit	90b	Pyll Mbrojtes	47	Mrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
201	833	Stoberde	Maja e Oplasit	91b	Pyll Prodhues	13.25	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
202	834	Stoberde	Shpati I Mjekrrbardhit	91c	Pyll Mbrojtes	11.25	Mrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
203	835	Stoberde	Shpati I Mjekrrbardhit	91d	Sip,Boshe	3.75		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
204	836	Stoberde	Shpati I Mjekrrbardhit	92a	Pyll Prodhues	12.35	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
205	837	Stoberde	Shpati I Mjekrrbardhit	92b	Sip.Çveshur	22.5		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
206	838	Stoberde	Shpati I Mjekrrbardhit	93	Pyll Mbrojtes	21.25	Mbrojtj Toke	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	

207	842	Stoberde	Lugu I Kuajve	97	Sip.Çveshur	42.25		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
208	844	Stoberde	Lugu I Kuajve	98b	Livadh	28	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
209	846	Stoberde	Lugu I Kuajve	99a	Sip.Çveshur	18.5		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
210	849	Stoberde	Lugu I Kuajve	100b	Sip.Çveshur	14.5		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
211	851	Stoberde	Shpati I Lugut Qorrzit	101b	Livadh	10.75	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
212	856	Stoberde	Maja e Qorrzit	104b	Sip.Çveshur	13.25		M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
213	861	Stoberde	Qorrzi	108b	Kullote	10.5	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	
214	863	Stoberde	Qorrzi	109b	Kullote	23.5	Kullote	M.M.P.A.U	D SH P Tropoje	

Numrat rendore të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
121-122,125,127,130-131,140,147,150	Pyll, kullotë etj.	Në pronësi
168-169,171-175,178,185,197-199,208-213		
233,239,244,274,278-280,286,293-294		
296-300,319,337,341,342,346-352,369,371		
373,379,404,440,442,444,448,450,452,454		
455,470-472,488,489,517-522,526,529-536		
543-545,561-563,569-572,575,576,586,587		
601-603,609,611,620-622,626,628,630-631		
637,642,645-647,651,670-681,689-698,701		
704,706-7-7,709,711,713,715,720-721,726,728		
731,734,736,740-742,744,749,751-753,757		
759,761-763,768-769,771,773-774,776,778		
779,781,785-787,790-791,794-795,803		
812-815,819,821-824,826-830,833-838,842		
844,846,849,851,856,861,863		

VENDIM
Nr.522, datë 23.4.2008

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR
TRAFIKIMIT TË MJETEVE MOTORIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të mjeteve motorike, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT
PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË MJETEVE MOTORIKE

Hyrje

Problemet e trafikeve të paligjshme në Shqipëri ashtu, si dhe në gjithë rajonin, filluan të konstatohen pas vitit 1990, kohë që përkon me ndryshimin e sistemeve politike. Kontaktet me rrjetet kriminale të vendeve fqinje bënë që elementët shqiptarë me prirje ose me precedentë penalë të krijojnë gradualisht mundësi për zhvillimin e lulëzimin e trafikeve të paligjshme, duke përfshirë edhe trafikimin e makinave të vjedhura.

Aktualisht Qeveria Shqiptare në programin e saj ka parashikuar si një nga prioritetet e punës së saj luftën kundër krimit të organizuar, ku përfshihet edhe trafikimi i makinave të vjedhura. Në këtë kuadër hartimi i një plani kombëtar veprimi do të ndihmojë në zhvillimin me sukses të luftës ndaj këtij aktiviteti kriminal. Ky plan veprimi është hartuar në bazë të përvojës dhe mësimave të nxjerra nga të gjitha institucionet kombëtare përgjegjëse për luftën kundër trafikimit të makinave.

Qëllimi i këtij plani është të konsolidojë përparimin e bërë deri tani dhe në të njëjtën kohë të zhvillojë metoda të reja ligjore dhe institucionale në përshtatje me specifikën në vendin tonë të fenomenit të trafikimit të makinave të vjedhura, si dhe të zhvillojë mënyra dhe metoda më efikase nga të gjitha institucionet kombëtare përgjegjëse për luftën kundër trafikimit të makinave.

Analizë

Fenomeni i trafikut të makinave nuk është problem vetëm i Shqipërisë, por një problem ndërkombëtar me përmasa shqetësuese për gjithë botën. Në trafikun ndërkombëtar të makinave të vjedhura ekzistojnë njëkohësisht vendet ku realizohen vjedhjet e makinave, vendet ku makinat kalojnë transit dhe vendet me destinacion tregu. Vendi ynë për makinat e vjedhura është një vend me destinacion tregu. Është provuar se tashmë ekzistojnë organizata ndërkombëtare kriminale të trafikut të makinave të vjedhura. Lidhjet midis trafikantëve vendosen shpejt dhe janë të qëndrueshme për aq kohë sa zhvillohet veprimtaria kriminale. Kështu trafikantët në vendet e origjinës marrin përsipër rolin e organizatorit të këtij trafikimi (vjedhjen e makinave, trukimin e tyre, pajisjen me dokumentacion për qarkullim), ndërsa trafikantët e tjerë janë në rolin e porositësit dhe transportit të tyre në vendet destinacion tregu. Përfitimi i siguruar nga ky trafik ndahet midis trafikantëve të vendeve të ndryshme, duke realizuar këtë bashkëpunim pa njohur kufij shtetërorë dhe duke shfrytëzuar mungesën e bashkëpunimit rajonal të policive për t'i goditur ata. Trafikantët shqiptarë në këtë bashkëpunim kryesisht kanë rolin e vjedhjes në vendet e origjinës të makinave të shtrenjta, transportimit dhe të gjetjes së tregut të shitjes në vendin tonë.

Për Policinë Shqiptare lufta kundër trafikut të makinave të vjedhura mbetet një nga prioritetet e saj në kuadrin e përgjithshëm të luftës kundër krimit të organizuar. Policia Shqiptare është angazhuar në disa operacione rajonale të iniciuara nga SECI ku mund të përmendim: operacionet e koduara “Road-Show (1, 2, 3)”; “Liqeni (1, 2, 3, 4)”, “Ketch”. Numri i makinave të identifikuara të trafikuar në vendin tonë ka ardhur nga viti në vit në rritje dhe nga këto numri më i madh i tyre rezultojnë të denoncuar të vjedhura në Itali. Automjetet janë prodhime të viteve të fundit 2002-2006 dhe dominojnë tipet e mjeteve Mercedes-Benz dhe BMW. Kohët e fundit janë konstatuar të trafikuar edhe tipet e makinave “Porsche”, “Caenne” dhe “Range Rover”.

Policia Shqiptare i ka të gjitha mundësitë dhe bazën ligjore që të përdorë metoda dhe mjete speciale të hetimit si: vëzhgimin e personit, makinës, përgjimet e telekomunikacionit, filmime dhe fotografime. Në Kodin e Procedurës Penale janë shtuar kohët e fundit dispozita për “teknikat e posaçme të hetimit” si blerja e stimuluar dhe agjentët e infiltruar.

Nga hetimi i rasteve rezulton se makinat e vjedhura kryesisht kanë hyrë nëpërmjet kufirit legal. Kalimi nëpërmjet vendkalimeve kufitare është i mundshëm pasi makinat kanë dokumentacionin e nevojshëm për hyrje dhe për momentin ato nuk rezultojnë të vjedhura pasi denoncimi për vjedhjen e tyre bëhet pas hyrjes në vendin tonë. Nga hetimi është vënë re edhe fenomeni i mashtrimit nëpërmjet siguracionit nga pronari i ligjshëm, si dhe fenomeni i kalimit të tyre me dokumente të falsifikuara. Për transportimin e automjeteve të vjedhura trafikantët shqiptarë përdorin shtetas të huaj, të cilët kundrejt pagesës nga trafikantët shqiptarë, hyjnë në vendin tonë me automjetin e vjedhur dhe kthehen në vendin e tyre pa automjet duke e lënë atë në adresën e përcaktuar më parë.

Vendkalimet kufitare më të përdorura nga trafikantët janë ato me Malin e Zi (Hani i Hotit) dhe

me Greqinë (Kakavijë, Tre Urat). Gjithashtu, në raste më të pakta janë shfrytëzuar edhe kalimet nëpërmjet kufirit jeshil në zonën kufitare me Malin e Zi (Hani i Hotit dhe Liqeni), me Greqinë (Qafë-Botë), me Maqedoninë (Blladë Qafë-Thinë) dhe me Kosovën (Morinë).

Legjislacioni shqiptar

Vjedhja e makinave në legjislacionin penal të Republikës së Shqipërisë nuk parashikohet si vepër penale më vete, pasi vjedhja e makinave konsiderohet si vjedhje pasurie. Në dispozitat ligjore të Kodit Penal për vjedhjet e pasurisë parashikohet edhe vjedhja e makinave.

Trafikimi i makinave është një dispozitë e re, e cila është shtuar në Kodin Penal me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 141/a, duke iu referuar legjislacionit ndërkombëtar bashkëkohor, por edhe me konsultë me misionet ndërkombëtare policore që monitorojnë Policinë Shqiptare dhe konkretisht citojmë:

“Importimi, eksportimi, transitimi dhe tregtimi në kundërshtim me ligjin i mjeteve motorike të vjedhura me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose me shumë se një herë ose sjell pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.”

Krime të tjera që lidhen me trafikimin e makinave janë “Falsifikimi i dokumenteve”, neni 186 i Kodit Penal “Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve”, neni 190 i Kodit Penal, “Kontrabanda me mallra të tjerë”, neni 174 i Kodit Penal.

Në legjislacionin tonë penal problemi i fajësisë midis “blerësit të pafajshëm” dhe pronarit që shet makinën është çështje civile dhe shqyrtohet në bazë të procedurave të përcaktuara në Kodin Civil të Republikës Shqiptare. Kjo zgjidhet me padi civile nga ana e “blerësit të pafajshëm”, por mund të shqyrtohet nga gjykata edhe gjatë procesit penal.

Konfiskimet apo kapjen e të ardhurave që rrjedhin nga krimi, bëhen duke u bazuar në:

- ligjin nr.9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, në të cilin përcaktohen rrethi i personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar, si dhe kompetencat e kriteret për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive që lidhen me këto krime;

- në Kodin Penal, neni 36 “Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale”, ku thuhet: “1. Konfiskimi jepet detyrimisht nga Gjykata...”.

Bashkëpunimi në fushën penale

Hetimi i rasteve të trafikimit të makinave të vjedhura kërkon marrjen e provave dhe përdorimin e tyre për dokumentimin ligjor dhe dënimin e autorëve. Informacioni që merret nëpërmjet *INTERPOLIT* e lejon fillimin e hetimit, por marrja e provave duhet të ndjekë rrugën e “Letërporosive ndërkombëtare”. Në Kodin e Procedurës Penale “Letërporositë ndërkombëtare” parashikohen në nenet 505 dhe 509 dhe autoriteti përkatës është Ministria e Drejtësisë. Përgjigjet e tyre në të shumtën e rasteve vijnë me vonë.

Vendi ynë vitet e fundit ka bërë një progres të dukshëm duke aderuar në instrumente europiane dhe ndërkombëtare, të cilat e lehtësojnë bashkëpunimin në fushën penale, sikurse dhe duke nënshkruar një numër të madh marrëveshesh dypalëshe. Por duhet pranuar se në luftën kundër trafikimit të makinave të vjedhura mungojnë format dhe instrumentet e këtij bashkëpunimi. Në vijim duhet të krijohet një sistem funksional i bashkëpunimit në fushën penale, duke pasur parasysh në mënyrë të veçantë, nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, me qëllim rritjen e bashkëpunimit në fushën penale.

Fuqitë (në cilat pika ndihemi të fortë):

- Ekziston vullneti politik dhe programi i Qeverisë për luftën kundër krimit të organizuar. Tashmë kemi strategjinë kombëtare të luftës kundër trafikëve të paligjshme.

- Kemi asistencën e organizmave ndërkombëtare e specialistëve të huaj.

- Kemi krijuar strukturat e specializuara të luftës kundër këtij trafikimi.

- Kemi krijuar eksperiencën tonë.

Dobësitë (në cilat pika ndihemi të dobët):

- Mungesa e një rrjeti kompjuterik kombëtar me të gjitha institucionet kombëtare që merren me trajtimin e makinave. Institucionet kombëtare të cilat kanë një rol të rëndësishëm në identifikimin e makinave të trafikuar janë: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e

Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, agjencitë e siguracionit. Ndërmjet këtyre institucioneve dhe Policisë së Shtetit ekziston një bashkëpunim në drejtim të shkëmbimit të informacionit, por në këtë bashkëpunim mungon mekanizmi i koordinimit të aktiviteteve.

- Procedimet penale të filluara nga ana e prokurorisë për makinat e trafikuar, në të shumtën e rasteve, për arsye se nga vendet e origjinës nuk kthehen përgjigjet e kërkuara me letërporositë ose këto përgjigje vijnë me vonesë, pezullohen dhe hetimet e tyre zgjasin pambarim.

- Në mjaft raste në trafikimin e makinave janë përfshirë pronarët e tyre, të cilët pasi i trafikojnë, i deklarojnë si të vjedhura.

- Makinat e sekuestruara të vjedhura në shumë raste u lihen në ruajtje deri në përfundim të gjykit personave që u janë sekuestruar këto mjete.

- Kemi mangësi në ruajtjen e kontrollin e kufirit shtetëror.

- Ekzistencën e rasteve të shkëputura të korrupsionit e të komprometimit të punonjësve që kryejnë procedura që nga momenti i hyrjes deri në regjistrimin e tyre.

- Ekzistenca e një tregu informal në tregtinë e makinave brenda vendit.

- Mungesa, në ndërgjegjësimin e publikut, e programeve të edukimit për rrezikun e ekzistencës së tregut të makinave të vjedhura.

Plani i veprimit

Plani i veprimit përmban këto elemente:

- objektivat;
- llojet e veprimtarive që do të kryhen;
- institucionet përgjegjëse;
- burimet financiare dhe partnerët e mundshëm në zbatimin e detyrës;
- treguesit e arritjeve të pritshme.

Objektivat

Objektivat kryesorë janë:

1. identifikimi i makinave të trafikuar, nëpërmjet përmirësimit të procedurave të gjetjes së makinave të vjedhura dhe bashkëpunimit me të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit;
2. identifikimi i trafikantëve të makinave, përfshirja e tyre në procese ligjore, përfundimi i hetimeve, dënimi i tyre dhe kthimi i makinave të vjedhura pronarëve të ligjshëm;
3. trajnimi dhe krijimi i kapaciteteve;
4. parandalimi i trafikimit të makinave të vjedhura.

OBJEKTIVI I
IDENTIFIKIMI I MAKINAVE TË TRAFIKUARA

Objektivi specifik (a): Drejtimi dhe bashkërendimi i veprimtarive të institucioneve kombëtare përgjegjëse për luftën kundër trafikimit të makinave të vjedhura, për të bërë të mundur efikasitetin e luftës kundër këtij trafikimi

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor	Tregues	Burimet
1. Krijimi i grupit ndërmësor të punës për monitorimin e luftës kundër trafikimit të makinave të vjedhura, me pjesëmarrjen e një përfaqësuesi të çdo institucioni përgjegjës (policia, dogana, transportet, tatimet). Në grupin e punës të marrë pjesë i ftuar edhe një përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme.	KM	2008	Monitorimi i luftës kundër trafikimit të makinave të vjedhura	Ekzistues
2. T'i propozohet Ministrisë së Drejtësisë që në kuadrin e shërbimit të unifikuar statistikor në fushën e drejtësisë, të ofrojë informacion statistikor për "Trafikimin e mjeteve motorike", me qëllim grumbullimin e të dhënave dhe statistikave që kanë lidhje me këtë vepër penale.	KM DPPSH DPD DPTRR DPT	2008	Të mbledhen dhe do të përdoren nga institucionet përgjegjëse statistika të sakta dhe të verifikueshme, si dhe të analizohen problemet që hasen.	Ekzistues
3. Të organizohen takime periodike për raportimin e të dhënave, përcaktimin e metodologjisë së mbledhjes dhe analizimin e problemeve që do të hasen në vazhdimësi.	KM DPPSH DPD DPTRR DPT	2008	Do të rrisë shkallën e bashkëpunimit e koordinimit ndërmjet institucioneve kombëtare dhe efektivitetin e luftës kundër këtij fenomeni.	Ekzistues

Objektiva specifik (b): Fuqizimi i kontrollit kufitar

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor	Tregues	Burimet
1. Të forcohet kontrolli në hyrje dalje të P.K.Kufitar të vendit tonë nëpërmjet zbatimit të rregullave strikte të kontrollit dhe gjetjes së formave e metodave më efikase për identifikimin e trafikantëve të makinave të vjedhura.	DPPSH	2008	1. Identifikimi i personave transportues të makinave të vjedhura, të cilët hyjnë në kufi me makina dhe dalin pa makina. 2. Identifikimi i makinave të vjedhura nëpërmjet kontrollit selektiv të makinave të reja të dyshuara. 3. Kapjen në flagrancë të trafikantëve të makinave të vjedhura dhe bashkëpunëtorëve të tyre.	Ekzistues
2. Të zbatohen forma dhe metoda bashkëkohore për kontrollin e plotë të kufirit shtetëror, nëpërmjet kontrollit edhe të vendeve në kufirin jeshil, që trafikantët përdorin për transportimin e makinave të vjedhura.	DPPSH	2008	1. Monitorimi i plotë i kufirit do t'i lejojë trafikantëve më pak mundësi për të transportuar nëpërmjet kufirit shtetëror makina të vjedhura. 2. Do të ndikojë në eliminimin e rasteve të hyrjes së makinave të vjedhura pa u regjistruar.	Ekzistues
3. Të përfundojë lidhja me sistemin TIMS e të gjitha P.K.Kufitar në vendin tonë, si dhe përdorimi i sistemit ASF2 të INTERPOLIT nga punonjësit e kësaj strukture që do të kenë akses.	DPPSH	2008	Do të mundësojë shkëmbimin e shpejtë të informacionit dhe identifikimin e makinave të vjedhura të trafikantëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre.	Në kuadër të programit TIMS
4. Pajisja e P.K.Kufitare me mjete teknike të posaçme për leximin automatik të targave, pajisje me komplete çelësash për hapje makinash, manuale me modele të makinave etj.	DPPSH	2008	Modernizimi P.K.Kufitar me pajisje teknike bashkëkohore të kontrollit për makinat do të ndihmojë personelin në evidentimin e makinave të vjedhura.	Donatorët
5. Përmirësimi në të ardhmen i sistemit të regjistrimit të makinave duke shtuar në këtë sistem më shumë të dhëna për makinat gjatë regjistrimit të tyre në P.K.Kufitar (të shtohet edhe regjistrimi i numrit të shasisë).	DPPSH	2008	Do të mundësojë kryerjen e verifikimeve për identifikimin e makinave të vjedhura që hyjnë e dalin në kufi dhe të trafikantëve e bashkëpunëtorëve të këtij trafikimi.	Ekzistues

Objektivi specifik (c): Fuqizimi i kontrollit doganor

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor	Tregues	Burimet
1. Të zbatohen rregulla strikte të procedurave të import-eksportit të makinave, gjatë kontrollit të kompanive që importojnë makina dhe pjesë këmbimi, si dhe ndaj individëve që sjellin makina nga jashtë për zbatimin e procedurave të import-eksportit të makinave.	DPD	2008	1. Njohja me procedurat ndërkombëtare të import-eksportit të makinave, njohja me specimentet e dokumenteve origjinale që duhet të shoqërojnë një automjet për shitjen dhe importimin e tyre. 2. Evidentimi i shkeljeve të procedurave gjatë importimit të makinave nga kompanitë dhe individët që sjellin makina nga jashtë.	Ekzistues
2. Të zbatohen kontrolle strikte për verifikimin e identiteteve të personave që deklarojnë makinat gjatë procedurave doganore për të identifikuar personat me identitet të rremë.	DPD DPPSH	2008	Kjo do të realizonte identifikimin e personave të lidhur me rrjetin e trafikimit të makinave të vjedhura.	Ekzistues
3. Të hartohet një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet DPD dhe DPPSH, ku të përcaktohen format dhe mënyrat e shkëmbimit të shpejtë të informacionit gjatë kryerjes së procedurave të regjistrimit dhe zhdoganimit të makinave me qëllim identifikimin e makinave të vjedhura të trafikuar, të kontrabanduara dhe të personave përgjegjës.	DPD DPPSH	2008	Shkëmbimi i shpejtë i informacionit për verifikimin dhe identifikimin e trafikantëve, falsifikatorëve të dokumenteve dhe makinave të vjedhura.	Ekzistues
4. Të organizohen dhe kryhen operacione të përbashkëta nga ana e strukturave doganore dhe strukturave të Policisë së Shtetit për kapjen e makinave të vjedhura dhe të autorëve të tyre që hyjnë në kufi jashtë rregullave doganore dhe kufitare.	DPD DPPSH	2008	Kjo do të bashkërendimin e veprimtarisë kontrolluese dhe operacionale ndërmjet këtyre institucioneve.	Ekzistues

Objektivi specifik (d): Përmirësimi i procedurave të regjistrimit të makinave

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor	Tregues	Burimet
-------------	---------------------------	-------------	---------	---------

1. Të përfundojë informatizimi i të gjitha shërbimeve për regjistrimin e makinave që kryhen nga drejtoritë e shërbimit të transportit rrugor.	DPSHTRR	2008	1. Unifikimi i programeve të regjistrimit të automjeteve të cilat kanë të njëjtën gjuhë programimi (ORACLE 9). 2. Lidhja në rrjete lokale me fibër optikë të 12 drejtorive rajonale të regjistrimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor.	Zbatim i projektit ekzistues
2. Forcimi dhe zbatimi rigoroz i rregullave dhe i procedurave të regjistrimit të automjeteve, me qëllim që të parandalohen rastet e regjistrimit të automjeteve të vjedhura dhe evitimin e pronarëve të rinj.	DPSHTRR	2008	1. Të përzgjidhen nga personeli dhe të vendosen në vendet ku bëhet regjistrimi i automjeteve, njerëz të kualifikuar që njohin procedurat dhe dokumentacionin e paraqitur. 2. Të rritet aftësia kontrolluese gjatë regjistrimit të makinave për verifikimin e numrave të shasisë dhe dokumentacionit të paraqitur për të konstatuar shkeljet dhe identifikuar personat përgjegjës.	Ekzistues
3. Të arrihet që nëpërmjet një memorandum bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor dhe Ministrisë së Brendshme të krijohet një lidhje online ndërmjet tyre për shkëmbimin e shpejte të informacionit.	DPSHTRR DPPSH	2008	1. Personeli i autorizuar i DPSHTRR do të ketë akses tek Modulet e TIMS-it për personat në kërkim dhe Sistemin ASF2 i INTERPOLIT për automjetet e trafikuar. 2. Personeli i DPPSH do të ketë akses te sistemet e informacionit të lejeve të drejtimit dhe regjistrimit të automjeteve. 3. Parandalimi i rasteve të regjistrimit të makinave të vjedhura.	Ekzistues
4. Të ndërtohet një Web aplikation mbi <i>data-basen</i> ekzistuese të Drejtorisë Rajonale	DPSHTRR	2008	1. Do të mundësojë në të ardhmen regjistrimin e makinave të cilat denoncohen të	Ekzistues donatorët

të Tiranës me perspektivë që të shfrytëzohet si <i>date-base</i> qendror për të gjithë vendin për makinat e vjedhura.			vjedhura një <i>data-base</i> qendrore kombëtare.	
5. Zbatimi i kontrolleve strikte të identiteteve të personave që deklarojnë makinat për regjistrimin e tyre për herë të parë apo për regjistrimin e ndryshimeve të pësura.	DPSHTRR	2008	Kjo do të realizonte identifikimin e makinave të vjedhura dhe të personave të lidhur me rrjetin e trafikimit të makinave të vjedhura.	Ekzistues

Objektivi specifik (e): Kontrolli i mjeteve në territorin shqiptar për identifikimin e makinave të vjedhura

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor	Tregues	Burimet
1. Të organizohen dhe kryhen operacione të përbashkëta për kontrollin e rregullave dhe procedurave ligjore që duhet të zbatojnë subjektet juridike dhe fizike të cilët tregtojnë e shesin makina në vendin tonë.	DPT DPPSH	2008	Eliminimi i tregut informal të makinave dhe identifikimin e personave të lidhur me trafikantë të makinave.	Ekzistues
2. Të organizohen dhe kryhen operacione të përbashkëta për kontrollin e automjeteve në qarkullim për rritjen e sigurisë publike dhe identifikimin e makinave me targa, dokumentacion dhe siguracion të falsifikuar.	DPPSH DPSHTRR DPT SHS	2008	1. Eliminimin e mangësive dhe problemeve që vërehen për automjetet që janë në qarkullim. 2. Identifikimin e makinave të vjedhura.	Ekzistues

OBJEKTIVI II

GODITJA DHE PËRFSHIRJA E TRAFIKANTËVE TË MAKINAVE DHE LIDHJEVE TË TYRE NË PROCESE LIGJORE.
PËRFUNDIMI I HETIMEVE DHE DËNIMI I TRAFIKANTËVE TË MAKINAVE,
KTHIMI I MAKINAVE TË VJEDHURA PRONARËVE TË LIGJSHËM

Objektivi specifik (a): Të rritet numri i ndjekjeve penale të suksesshme për trafikantët e makinave të vjedhura dhe krime të lidhura me to, përfshirë punonjës të policisë, të doganave, të transporteve dhe punonjës të tjerë shtetërorë

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor	Tregues	Burimet
1. Të rritet bashkëpunimi me prokurorinë për thellimin e hetimeve të proceseve ligjore të filluara për “Trafikim të mjeteve motorike” dhe veprat penale që lidhen me to.	PP DPPSH DPD DPSHTRR	2008	Mbledhja e të dhënave për autorët e këtyre veprave penale dhe kryerja e analizave të përbashkëta me prokurorinë.	Ekzistues
2. Të nisen më shumë çështjet penale me autorë të arrestuar në raport me çështjet penale me autorë në gjendje të lirë, nëpërmjet mbledhjes së të dhënave për autorët e këtyre veprave penale, analizimit të përbashkët me prokurorinë dhe aplikimit të metodave speciale të hetimit.	PP DPPSHDPD DPSHTRRDPT	2008	Përfshirja në procese ligjore e trafikantëve dhe lidhjeve të tyre kriminale.	Ekzistues
3. Orientimi i një politike të ashpër penale ndaj punonjësve të institucioneve kombëtare përgjegjëse, të cilët abuzojnë me detyrë nëpërmjet aplikimit të sanksioneve të Kodit Penal dhe jo vetëm të masave administrative.	PP DPPSH DPD DPSHTRR DPT	2008	1. Nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit të institucioneve kombëtare përgjegjëse me prokurorinë për ndëshkimin ligjor të këtyre rasteve. 2. Të raportohet në mënyrë periodike nga institucionet kombëtare përgjegjëse mbi masat disiplinore administrative, si dhe ndjekjet penale/dënimet e punonjësve të ndëshkuar.	Ekzistues
4. Të punohet në drejtim të grumbullimit dhe përpunimit të informacioneve për falsifikatorët e makinave dhe dokumenteve, identifikimin e vendeve ku realizohen dhe të merren masa efektive për goditjen dhe dënimin e tyre.	DPPSH DPD DPSHTRR DPT	2008	Të rritet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve kombëtare për shkëmbimin e informacioneve, për identifikimin e falsifikatorëve dhe i vendeve ku realizohen ato.	Ekzistues
5. T’i kërkohet Ministrisë së Drejtësisë që dispozita e “Trafikimit të mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal t’i kalojë për kompetencë Prokurorisë së Krimeve të Rënda	DPPSH DPD DPSHTRR	2008	Kryerja e hetimeve më të suksesshme për këtë vepër penale dhe të përfundimit të dënimeve të trafikantëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre.	Ekzistues

Objekтиви специфич (b): Пërfundimi i hetimeve dhe dënimeve të suksesshme të trafikantëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor	Tregues	Burimet
1 .Të rritet numri i çështjeve penale në gjykim dhe i dënimeve të autorëve të këtyre veprave penale.	PP DPPSH DPD	2008	Të rritet bashkëpunimi me prokurorinë të institucioneve kombëtare përgjegjëse për sigurimin e provave për autorët e	Ekzistuese

	DPSHTRR		këtyre veprave penale.	
2. Të nënshkruhen marrëveshje bashkëpunimi ndërkombëtare në fushën penale, gjatë hetimit dhe gjatë procesit gjyqësor për përfundimin e hetimeve dhe dënimin e trafikantëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre.	PP	2008	Të gjenden rrugë dhe mënyra më efikase për shpejtimin e procedurave të kthimit të përgjigjeve të letërporosive.	Ekzistues
3. Të nënshkruhen marrëveshje bashkëpunimi ndërkombëtare policore të drejtpërdrejtë dhe të ndërsjellë për shkëmbimin e informacioneve apo të dhënave të shërbimeve të inteligjencës.	PP DPPSH	2008	Marrëveshje ndërkombëtare dypalëshe për të caktuar pika kontakti, metoda dhe kanalet e bashkëpunimit.	Ekzistues
4. T'i kërkohet Prokurorisë së Përgjithshme që për automjetet e sekuestruara për "Trafikim të mjeteve motorike", neni 141/a i Kodit Penal, nëpërmjet një qarkore të orientojë prokuroritë vartëse që këto automjete të mos u lihen në ruajtje poseduesve të tyre, por të sigurohen në vende parkimi nga drejtoritë e policive në qarqe.	PP DPPSH	2008	Të merren masa nga ana e drejtorive të policisë në qarqe që makinat e sekuestruara të sigurohen në parkime të miratuara dhe të siguruar.	Ekzistues, donatorët

OBJEKTIVI III TRAJNIMI DHE KRIJIMI I KAPACITETEVE

Objektivi specifik (a): Të zhvillohen programe të gjera trajnimi me specialistët e institucioneve kombëtare që janë përgjegjëse për makinat e vjedhura të trafikuar, për shtimin e njohurive profesionale të tyre

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor	Tregues	Burimet
1. Të institucionalizohen kurse trajnimi me punonjësit e institucioneve kombëtare përgjegjëse për shtimin e njohurive profesionale me qëllim identifikimin e veprave penale që lidhen me makinat e vjedhura e të trafikuar.	DPPSH DPD DPSHTRR DPT	2008	Kryerja e një studimi mbi nevojat për trajnimet dhe përcaktimi i temave për trajnim.	Donatorët
2. Trajnimi i punonjësve të institucioneve kombëtare përgjegjëse që merren direkt me problemet e makinave të vjedhura e të trafikuar.	DPPSH DPD DPSHTRR DPT	2008	Përcaktimi i punonjësve që do të trajnohen nga çdo institucion.	Donatorët

OBJEKTIVI IV
PARANDALIMI I TRAFIKIMIT TË MAKINAVE TË VJEDHURA

Objektivi specifik (a): Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për domosdoshmërinë e luftës kundër fenomenit të trafikimit të makinave të vjedhura

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor	Tregues	Burimet
1. Të rritet ndërgjegjësimi ndërmjet punonjësve të institucioneve kombëtare përgjegjëse dhe gjyqtarëve e prokurorëve për bashkëpunimin ndërmjet tyre për rritjen e efekshmërisë së hetimeve që lidhen me trafikimin e makinave të vjedhura.	DPPSH DPD DPSHTRR DPT	2008	Efikasiteti i punës së institucioneve kombëtare përgjegjëse për goditjen e këtij aktiviteti kriminal.	Ekzistues
2. Të rritet ndërgjegjësimi i opinionit publik për efektet negative për ekonominë dhe shoqërinë shqiptare të ekzistencës së tregut të makinave të vjedhura.	DPPSH DPD DPSHTRR DPT	2008	Emisione televizive, spote publicitare për efektet negative për ekonominë dhe shoqërinë shqiptare.	Donatorë

FJALORI I SHKURTIMEVE TË PËRDORURA

KM	Këshilli i Ministrave
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
PP	Prokuroria e Përgjithshme
MF	Ministria e Financave
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DPSHTRR	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
SHS	Shoqëritë e siguracionit

VENDIM **Nr.524, datë 23.4.2008**

PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN E MALDIVEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Maldiveve.
 2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM **Nr.525, datë 23.4.2008**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.666, DATË 26.10.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA MASA LIDHUR ME PROCESIN E LIKUIDIMIT TË NDËRMARRJEVE TË VARËSISË SË ISH-AGJENCISË QENDRORE TË RISTRUKTURIMIT DHE PRIVATIZIMIT TË NDËRMARRJEVE BUJQËSORE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për saksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private, të pavarura, dhe privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.666, datë 26.10.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronjat “a” e “ç” të pikës 1 ndryshohen si më poshtë vijon:
“a) Arkëtimi i pagesave të kësteve të mbetura, të detyrimeve finaciare nga shitja e pasurisë shtetërore të ndërmarrjeve bujqësore, bëhet në lekë, sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr.794,

datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurat e shitjes”.”.

“ç) debitorët privatë, për objektet ndërtimore, të kontabilizuara sipas vendimit nr.403, datë 15.8.1994 të Këshillit të Ministrave, ose për rastet e tjera, të vëna re më vonë, do t’i paguajnë detyrimet financiare, 100 për qind, në lekë.

Vlera e çdo objekti ose një pjese të tij llogaritet në bazë të vlerës kontabile fillestare, e cila pakësohet me vlerën kontabile të amortizimit (deri në çastin e zaptimit), sipas vendimit nr.401, datë 23.10.1989 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e normave të reja të amortizimit të makinerive, të pajisjeve, si dhe të mjeteve të transportit”. Vlera e mbetur korrigjohet me koeficientin e vendndodhjes dhe me indeksin mujor të çmimeve. Ky vlerësim bëhet nga financieri ose ekonomisti i privatizimit dhe miratohet nga drejtori i drejtorisë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, në prefekturën përkatëse.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Privatizimi i pasurisë shtetërore të ndërmarrjeve, në varësi të ish-Agjencisë Qendrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore (AQRPNB), e cila nuk është e klasifikuar dhe e trajtuar sipas vendimit nr.403, datë 15.8.1994 të Këshillit të Ministrave, të bëhet sipas vendimeve nr.794, datë 21.11.2007 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurat e shitjes”, dhe nr.850, datë 21.11.2007 “Për kriteret dhe procedurat e shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore apo të objekteve shtetërore të veçuara, të privatizuara” të Këshillit të Ministrave.”.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.526, datë 23.4.2008

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE
SHOQËRISË “LNK” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “SLLABINJË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “LNK” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Sllabinjë”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR.2326 rep.
NR.669/3 kol.

KONTRATË KONCESIONI

E FORMËS “BOT” (NDËRTIM, OPERIM, TRANSFERIM) PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “SLLABINJË”

Në Tiranë, në datën 11.4.2008 (dy mijë e tetë), para meje notere Drita Pepi, e regjistruar në dhomën e noterisë Tiranë, me adresë: rruga Gj.Fishta u paraqiten palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës përcaktuar si “Autoritet Kontraktues” me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.307, datë 25.5.2007 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të hidrocentralit “Sllabinjë”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë”, që më poshtë do të quhet i tillë, përfaqësuar nga z.Kristo Rodi, i biri i Stefanit, i datëlindjes 11.6.1957, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi NF nr.489018 dhe

Shoqëria “LNK” sh.p.k., regjistruar si person juridik me vendimin nr.24244, datë 31.7.2000, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, që më poshtë do të quhet “Koncesionari”, përfaqësuar nga administratori z.Naimir Kurti, i biri i Luanit, i datëlindjes 6.3.1976, banues në Tiranë, rruga “Vëllezër Manastirliu”, nr.60/3, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta S 0001441, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Hyrje

Duke pasur parasysh që Qeveria e Shqipërisë:

a) i ka dhënë një rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të rinj ose rehabilitimit të hidrocentraleve ekzistuese me anë të procedurave të koncesionit për përmirësimin e treguesve teknikë dhe ekonomikë të rrjetit elektrik kombëtar;

b) konsideron ndërtimin e hidrocentraleve si një element të rëndësishëm të politikës së zhvillimit të sektorit të energjisë;

c) vlerëson formën “BOT” të koncesionit, si një formë koncesioni që bën të mundur stimulimin e investitorëve privatë për ndërtimin e hidrocentraleve të rinj me anë e kapitalit privat;

d) është e angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike brenda vendit;

e) mirëpret investitorët vendas ose të huaj në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike;

f) me anë e legjislacionit në fuqi rregullon dhënien me koncesion të hidrocentraleve dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.307, datë 25.5.2007 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të hidrocentralit “Sllabinjë”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë”, autorizohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për negociimin dhe nënshkrimin e kontratës së koncesionit.

Koncesionari:

1. është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentralit “Sllabinjë”, në komunën Proptisht, rrethi Pogradec, me qëllim prodhimin e energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike të zonës;

2. shoqëria “LNK” sh.p.k., zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiare, për të realizuar projektin e miratuar sipas objektit të kësaj marrëveshjeje;

3. ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentralit “Sllabinjë”, objekt i këtij koncesioni;

4. zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara, si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Palët bien dakord për sa vijon:

Neni 1

Përkufizime

Termat e mëposhtëm, kudo që përdoren në këtë kontratë, kanë kuptimet që jepen në vijim:

- 1.1 Kontratë koncesioni: është një kontratë dhe anekset 1 dhe 2 bashkëlidhur.
- 1.2 Autoriteti Kontraktues: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
- 1.3 Koncesionari: shoqëria "LNK" sh.p.k., me seli në qytetin e Tiranës.
- 1.4 Hidrocentral: tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike, ku përfshihen vepra e marrjes, kanali i devijimit, baseni i presionit, tubacioni që dërgon ujin në turbina, ndërtesa e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e instaluar në të, që në rastin konkret është hidrocentrali "Sllabinjë", komuna Proptisht, rrethi Pogradec, me fuqi të instaluar 9 300 kW dhe prodhim të energjisë elektrike rreth 50 000 000 kWh, së bashku me të gjitha objektet që përmenden më sipër.
- 1.5 Kontratat e sipërmarrjes: të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari me sipërmarrësit për kryerjen e punimeve.
- 1.6 Tarifa koncesionare: sasia e energjisë elektrike që i ofrohet pa pagesë shtetit.
- 1.7 Projektide: dokumentacioni teknik dhe ekonomik për planifikimin, financimin, projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e hidrocentralit.
- 1.8 Projekti i zbatimit: projekti i detajuar inxhinierik, i cili përmban parametrat, karakteristikat dhe specifikimet përfundimtare të hidrocentralit.

Neni 2

Objekti i koncesionit

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është ndërtimi, shfrytëzimi dhe transferimi i hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave të kësaj kontrate.

Neni 3

Afati i koncesionit

Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit me koncesion të formës BOT, hidrocentralin "Sllabinjë", për një periudhë 35-vjeçare.

Një vit para përfundimit të kësaj periudhe, palët, me vullnet të përbashkët, mund të zgjasin afatin e kësaj kontrate, kur vlerësohet se nga ana e Koncesionarit janë përmbushur me korrektesë të gjitha detyrimet dhe Autoriteti Kontraktues e konsideron me interes vazhdimësinë e kontratës.

Kjo periudhë do të fillojë nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate.

Neni 4

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

4.1 Të asistojë Koncesionarin pranë çdo institucioni, organi a agjencie shtetërore, qendrore a vendore, kur është e nevojshme, për marrjen e licencave, autorizimeve dhe të lejeve që do t'i shërbejnë për ekzekutimin e punimeve dhe zbatimin e kësaj kontrate.

4.2 Të garantojë Koncesionarin se nuk do të lidhë asnjë marrëveshje tjetër që mund të dëmtojë a pengojë prurjet ditore, stinore ose vjetore në hidrocentral.

4.3 Të kontrollojë rregullisht ecurinë e kontratës, sipas kushteve të përcaktuara në të.

4.4 Të garantojë blerjen e energjisë elektrike nga shoqëria KESH sh.a. për 15 vitet e para të prodhimit të energjisë elektrike, me çmimin sipas formulës së përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007.

4.5 Të miratojë projektin e zbatimit të hidrocentralit. Koha e nevojshme për miratimin e projektit të zbatimit nuk bën pjesë në grafikun e punimeve të parashikuar në aneksin 2, bashkëlidhur.

Neni 5

Detyrimet e Koncesionarit

5.1 Koncesionari është i detyruar të zbatojë projektin dhe objektin e kontratës në përputhje me kushtet dhe afatet e parashikuara në këtë kontratë.

5.2 Koncesionari është i detyruar:

a) të formojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate shoqërinë koncesionare, që do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj hartimin e projektit të zbatimit ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin e hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues pas përfundimit të afatit të koncesionit; shoqëria koncesionare do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri, si dhe në rast transferimi të aksioneve apo pjesëve të kapitalit të saj të të tretet, duhet të marrë pëlqimin me shkrim të autoritetit kontraktues;

b) të zbatojë punimet dhe planin e investimit sipas aneksit nr.1 bashkëlidhur kësaj kontrate;

c) të kryejë investimin sipas afateve të parashikuara në këtë kontratë dhe në cilësinë e kërkuar;

d) të fillojë punën brenda 30 ditëve nga data e miratimit të projektit të zbatimit;

e) të menaxhojë dhe administrojë hidrocentralin gjatë gjithë periudhës së koncesionit;

f) të përballojë shpenzimet që lidhen me dëmet që mund t'i shkaktohen palëve të treta për faj të vet;

g) të informojë Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ndikojë në zbatimin e projektit të zbatimit;

h) të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj;

i) të marrë masa për të garantuar kushtet e sigurimit në punë për punëtorët dhe personat e tjerë, për të shmangur dëmet ndaj pronës publike dhe private, si dhe të respektojë legjislacionin në lidhje me parandalimin e dëmeve a fatkeqësive në punë;

j) të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe ato noteriale;

k) të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues projektin e zbatimit sipas grafikut të punimeve, të parashikuara në aneksi 2, bashkëlidhur.

Të zbatojë projektin e zbatimit për ndërtimin e HEC-it "Sllabinjë".

Neni 6

Vlerësimi i investimeve

6.1 Vlera e investimeve që duhet të kryhet nga Koncesionari, sipas aneksit 1, është në vlerën totale prej 1 290 117 487 (një miliard e dyqind e nëntëdhjetë milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë) lekësh, nga të cilat 620 003 100 (gjashtëqind e njëzet milionë e tremijë e njëqind) lekë do të investohen në makineri e pajisje.

6.2 Vlera e mësipërme mund të pësojë ndryshime me marrëveshje ndërmjet palëve:

- pas të jetë paraqitur projekti i zbatimit;

- në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës, sipas efektivitetit të ofertave.

6.3 Vlera e ndryshuar e investimit mund të jetë më e madhe se 1 290 117 487 (një miliard e dyqind e nëntëdhjetë milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, por jo më e vogël se 1 225 611 612 (një miliard e dyqind e njëzet e pesë milionë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë) lekë, që përfaqëson një ndryshim të investimit në vlerën 5% të investimit total të parashikuar.

Neni 7

Programi i punimeve

Koncesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm të punimeve:

7.1 Koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 18 (tetëmbëdhjetë) muajve nga marrja e lejes së ndërtimit, por jo më vonë se 24 (njëzet e katër) muaj nga miratimi i kësaj kontrate.

7.2 Ky afat mund të ndryshojë me marrëveshje midis palëve, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse vonohet përtej kohës së rregullt procedurale për marrjen e tyre.

Neni 8

Zgjidhja e kontratës së koncesionit

8.1 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kësaj kontrate në mënyrë të njëanshme:

a) kur Koncesionari nuk fillon punën brenda 6 muajve nga data e miratimit të projektit të zbatimit;

b) në rast të mosrealizimit të fuqisë së vendosur mbi 10 % të asaj sipas projektzbatimit të propozuar nga Koncesionari;

c) kur Koncesionari transferon kuotat ose kapitalin pa marrë miratimin e Autoritetit Kontraktues.

8.2 Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë afatit të koncesionit ka shkelje të detyrimeve, kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë kontratë, Autoriteti njofton për këtë Koncesionarin, duke i kërkuar këtij të japë arsyet për shkeljet e konstatuara brenda një periudhe prej 30 ditësh. Në rast se brenda këtij afati Koncesionari nuk përgjigjet, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë.

8.3 Në rast se Autoriteti Kontraktues zgjidh kontratën në mënyrë të njëanshme (pika 8.1 e këtij neni), Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e garancisë së kontratës. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht administrimin e HEC-it, për sigurimin e një shërbimi efektiv dhe të pandërprerë dhe, në rastin e dështimit të Koncesionarit, të përbushë detyrimet e tij kontraktuale dhe të dështimit të tij, për të rregulluar shkeljen e kontratës.

8.4 Secila palë, ka të drejtë ta zgjidhë kontratën kur:

a) përbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave që kanë qenë jashtë kontrollit të arsyeshëm të secilës palë;

b) ka shkelje serioze nga njëra palë, shkelja e cila nuk mund të korrigjohet brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së parashikuar në këtë kontratë.

8.5 Palët kanë të drejtë ta zgjidhin këtë kontratë me pëlqim të dyanshëm.

Neni 9

Kontratat

9.1 Me qëllim që të realizohet objekti i koncesionit, Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje. Në lidhjen dhe nënshkrimin e kontratave të sipërmarrjes me nënkontraktorët, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj kontrate.

9.2 Pavarësisht nga kontratat e sipërmarrjes, Koncesionari mbetet përgjegjës para Autoritetit Kontraktues për zbatimin e rregullt të këtyre kontratave të sipërmarrjeve. Me përjashtim të detyrimeve që ka sipas kësaj kontrate, Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve. Autoriteti Kontraktues ka të drejtën, por jo detyrimin, të ndërhyjë në çdo kontratë të Koncesionarit.

9.3 Koncesionari nuk ka të drejtë ta japë kontratën e koncesionit me nënkoncesion.

Neni 10

Garancitë

10.1 Koncesionari duhet të garantojë, për llogari të Autoritetit Kontraktues (sipas formularit të paraqitur në dokumentet e tenderit), para firmosjes së kontratës, një shumë të barabartë me 10% të vlerës totale të investimit prej 129 011 749 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet e nëntë) lekësh.

10.2 Koncesionarit i lejohet të çngurtësojë këtë vlerë vetëm pasi të ketë marrë konfirmimin nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditëve nga realizimi i investimit dhe vënia në punë e të gjithë veprës.

Neni 11

Sigurimet

11.1 Koncesionari siguron hidrocentralin gjatë gjithë afatit të koncesionit dhe një kopje të

policës së sigurimit e depoziton çdo vit pranë Autoritetit Kontraktues.

11.2 Në rast se hidrocentrali shkatërrohet ose dëmtohet për shkakë për të cilat ai është siguruar, zhdëmtimet financiare që vijnë nga siguracionet do të përdoren nga Koncesionari për të rindërtuar, riparuar dhe rikthyer hidrocentralin në gjendjen e mëparshme përpara shkatërrimit ose dëmtimit.

11.3 Koncesionari duhet të sigurohet për përgjegjësinë për dëmet materiale dhe fizike që mund t'u shkaktohen palëve të treta, si rrjedhojë e punimeve të ndërtimit/montimit të hidrocentralit, si dhe gjatë shfrytëzimit të tij.

11.4 Sigurimi i objekteve do të kryhet për kufij përgjegjësie jo më të ulët se 200 000 (dyqind mijë) euro për çdo ngjarje, deri në 500 000 (pesëqind mijë) euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jetë më e lartë se 1000 (një mijë) euro për çdo ngjarje dhe 2000 (dy mijë) euro në vit.

11.5 Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 12

Kontrolli, raportimi, inspektimet dhe mbikëqyrja e përgjithshme

12.1 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kontrollojë Koncesionarin gjatë gjithë afatit të koncesionit.

12.2 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që gjatë fazës së ndërtimit të hidrocentralit të inspektojë dhe kontrollojë punimet për të parë përmbushjen e kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë kontratë.

12.3 Koncesionari raporton me shkrim çdo tre muaj tek Autoriteti Kontraktues për realizimin e programit të punimeve (investimeve), në vlerë dhe në natyrë, dhe pas fillimit të shfrytëzimit, çdo gjashtë muaj për ecurinë e projektit sipas kushteve të kontratës koncesionare.

12.4 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të mbikëqyrë ecurinë e punimeve dhe cilësinë e kryerjes së tyre, nëse janë në përputhje me programin e punimeve dhe me dokumentacionin e projektit përfundimtar.

12.5 Në rast të shkeljeve të kontratës, konstatuar gjatë kontrollit të përgjithshëm, Koncesionari do të njoftohet me shkrim për masat që do të merren dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

Neni 13

Tarifa koncesionare dhe vlera e riinvestimit

13.1 Tarifa koncesionare është 3.5 % e energjisë së prodhuar, të cilën Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ta shesë këtë sasi energjie për llogari të tij.

13.2 Vlera e riinvestimit është 70 % e vlerës së investimit për makineritë dhe pajisjet. Kjo vlerë do të investohet çdo 15 vjet dhe do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.

Neni 14

Legjislacioni i zbatueshëm

Zbatimi dhe interpretimi i kësaj kontrate koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 15

Forca madhore dhe të paparashikuara

15.1 Konsiderohen ngjarje të forcës madhore katastrofat e natyrës, përmbytjet, tërmetet, thatësira, lufta dhe ndërhyrja e palëve të treta që kanë fuqinë e ligjit dhe çdo ngjarje tjetër e njëjtë, që mund të ndikojë në përmbushjen e kësaj kontrate, si dhe të detyrimeve reciproke që parashikohen në këtë kontratë, që nuk varen nga vullneti i palëve ose që nuk kanë të bëjnë me vullnetin e tyre.

15.2 Në rast se verifikohen vonesa në realizimin e kësaj kontrate ose mospërmbushje të

detyrimeve të palëve, si pasojë e ngjarjeve të forcës madhore, vonesat ose mospërbushja nuk mund të shërbejnë si bazë për çdo palë për të kërkuar zhdëmtim nga pala tjetër.

15.3 Kur një detyrim i kësaj kontrate nuk do të zbatohet ose përbushet si rezultat i forcës madhore, pala e dëmtuar njofton me shkrim palën tjetër, brenda 30 ditëve, shtyrjen e afatit të punimeve ose braktisjen e tyre, si dhe/ose masat që do të merren për kapërcimin e pasojave.

15.4 Afati i ndërprerjes së punimeve dhe shtyrja në kohë e tyre do të përcaktohen nga palët në një procesverbal menjëherë pas ndodhjes së ngjarjes së forcës madhore.

Neni 16

Hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit

Kontrata e Koncesionit do të hyjë në fuqi mbasi të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”.

Neni 17

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

17.1 Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj kontrate koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.

17.2 Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje që lidhet me këtë kontratë koncesioni, do të jetë gjykata e arbitrazhit që do të krijohet dhe funksionojë sipas parashikimeve të neneve 400 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

17.3 Fillimi apo vazhdimi i negociatave për zgjidhje me dialog, apo i procedurave gjyqësore/të arbitrazhit nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të kontratës dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj kontrate.

Neni 18

Sanksionet

Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj kontrate, në përfundim të periudhës 18- mujore (tetëmbëdhjetë mujore) penalizon Koncesionarin si më poshtë:

- a) për shkelje të afatit të ndërtimit, 0,05 % në ditë të vlerës së investimeve të munguara;
- b) për moskryerje të investimeve në vlerën e marrë përsipër në konkurrim, Koncesionari penalizohet me 10 % të vlerës së investimeve të paraleluara;
- c) për çdo ditë vonese për fillimin e punimeve penalizohet me 10 000 lekë;
- d) në rast mosrealizimi, për faj të Koncesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 50 000 000 KWh/vit, Koncesionari penalizohet me 5% të vlerës së prodhimit të paraleluar për periudhën raportuese;
- e) për mosrealizim deri në 10% të fuqisë së vendosur sipas projektit të propozuar nga Koncesionari, ai do të penalizohet me 5% të vlerës së prodhimit të energjisë elektrike të munguar, si pasojë e zvogëlimit të fuqisë së instaluar;
- f) nëse mosrealizimi i fuqisë së vendosur është më shumë se 10 % e fuqisë së vendosur sipas projektit të propozuar nga Koncesionari, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ta prishë kontratën në mënyrë të njëanshme.

Neni 19

Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit

19.1 Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari zotohen me vullnet të plotë të bashkëpunojnë për realizimin e plotë të kësaj kontrate.

19.2 Korrespondenca do të dërgohet me letër me postë, telegram ose fax në adresat përkatëse.

19.3 Për çdo ndihmë që do t'i kërkohej Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë, Koncesionari i paraqet Autoritetit kërkesë me shkrim.

Neni 20
Transferimi i aseteve

Me mbarimin e kësaj kontrate, qoftë si përfundim i afatit të zakonshëm, ose si një mbarim i parakohshëm i saj, asetet e koncesionit, përfshirë çdo ndërtesë apo impiant të ndërtuar nga Koncesionari në kantierin e koncesionit, i transferohen Autoritetit Kontraktues, të lirë nga ndonjë detyrim, objekt i afateve dhe kushteve të kësaj kontrate koncesionare.

Neni 21
Regjistrimi i hidrocentralit

Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e saj, kontrata duhet të regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të Autoritetit Kontraktues.

AUTORITETI KONTRAKTUES

KONCESIONARI

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe
Energjetikës

Shoqëria “LNK” sh.p.k.

Përfaqësuar me autorizimin nr.1822/26,
datë 11.12.2007 të
Ministrit të Ekonomisë,
Tregtisë dhe Energjetikës,
Nga z.Kristo Rodi
Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore

Përfaqësuar nga
Administratori
Naimir Kurti

PREVENTIV NR 1

ANEKSI 1

PER PUNIMET QE DO TE KRYHEN SIPAS GRAFIKUT (aneks2)

EMERTIMI I VEPRES : Punime ndertimi HC/SLLABINJE 1

Investitori: "L.N.K " shpk

Sipermarresi : Naimir Kurti

Nr	Lloji i punimeve	Vlera ne mije leke	Normat e projektimit dhe zbatimit
1	Vepra e marrjes		Manuale e preventivave ,kushtet teknike
	Germime 80% shkemb.Betonime .Veshje me gabiona ,Hekur betoni	21.757,5	
	Konstruksione metalike, mekanizma ngrites		
2	Kanali percjelles nga lumi shkumbin		Manuale e preventivave ,kushtet teknike
	Germime 80% shkemb.Betonime parafabrikat dhe shtresa betoni	43.249	
	Nenshtresa zhavorri, hekur betoni, tub celiku, saracineska		
3	Vepra e marrjes nga Dushna		Manuale e preventivave ,kushtet teknike
	Germime 80 % shkemb, betonime, hekur betoni, konstruksione metalike,	9.661,7	
	mekanizma ngrites, veshje gabiona		
4	Kanali i sjelljes nga lumi Dushna		Manuale e preventivave ,kushtet teknike
	Germime 80 % shkemb, betonime dhe betone parafabrikat	91.224,4	
	nenshtresa zhavorri, tub celiku, hekur betoni, saracineska		
	konstruksione metalike, izolim tubacioni		
5	Tuneli hidro teknik		Manuale e preventivave ,kushtet teknike
	Tuneli i mbaruar plotesisht	359.100,0	
6	Baseni nen presion		Manuale e preventivave ,kushtet teknike
	Germime shkemb, betoni, nenshtrese zhavorri, konstruksione metalike	6.742,7	
	per porta mbyltese te shpejta, zgara, mekanizma ngritese.		
7	Tubacioni i turbinave		Manuale e preventivave ,kushtet teknike
	Germime, betone, tubacione celiku, unaza celiku, mbeshtetese	23.891,0	
	dhe rreshqitese tip shine, kompensantor		
8	Ndertesa a centralit		Manuale e preventivave ,kushtet teknike
	Godina e centrale+vinc ure, kanali i largimit, mur rrethues me beton	23.620,0	
	mbrojtje me gabiona		
9	Rruga dhe ndertesa sherbimi		Manuale e preventivave ,kushtet teknike
	rruge kantieri me cakell: Sllabinje-Uloshnik, Ura-Trebinje, ndertese	43.394,8	
	sherbimi definitive ne Losnik, ndertese sherbimi ne Trebinje, ure pasarele		
	linje tensione 220 W, Sllabinje-vepra e marrjes, linje tensioni 35 kW		
	SHUMA (1+2+3+4+5+6+7+8+9)	622.641,1	
	NGRITJE KANTIERI 2.5 %	15.566,03	
	FOND REZERVE 5%	31,910	
	SHUMA TOTALE	670.117,5	
10	Makineri e paisje		Rregullat e sig tekink te
	Agregate hidrofurbo, kuadri elektrik komplet +transformator	620.000,0	shrytezimit te hidrocentraleve
	TOTALI	1.290.117,5	

L.N.K

CERTIFIKATË GARANCIE KONTRATE
Nr.16/0101/ 024562.



Për: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës,
Blv. Dëshmorët e Kombit, 1001, Tiranë.

Duke qenë se **"L.N.K" sh.p.k.** me adrese Rruga Naim Frasheri, Pall.60,Shk.2,Ap.2, Tirane ka marrë përsipër në bazë të Kontratës _____, të realizojë:

(Projektimi, Ndërtimi, Shfrytëzimi, dhe Transferimi i hidrocentralit "SLLABINJE", me adrese: Komuna Proptisht, rrethi Pogradec tek Autoriteti Kontraktues, Referenca e koncesionit nr.008.00.18)

Duke qenë se në Kontratën si më sipër kërkohet Garanci në shumën prej:

129,011,749 LEKE (*Njëqind e njëzet e nente milion e njëmbëdhjetemije shtatëqind dyzetë nente leke*), si sigurim për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në kontratë.

Duke qenë se **SIGAL sh.a.** është Garantues i zbatimit të Kontratës së mësipërme ose i pagesës deri në shumën totale prej **129,011,749 LEKE**, e cila është e pagueshme në mënyrën dhe monedhën e përcaktuar në Kontratë.

Ne marrim përsipër t'i paguajmë **"Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, Tiranë** sapo të bëjë kërkesën e parë me shkrim dhe pa qenë nevoja të bëjë argumentim të kërkesës çdo shumë brenda kufirit prej **129,011,749 LEKE** ose përmbushjen e të gjithë detyrimeve kontraktore të "L.N.K" sh.p.k përcaktuar në Kontratë duke gëzuar të drejtat e saj sipas Kontratës.

Me këtë Garanci ju sigurojmë se nuk është nevoja t'i drejtoheni më parë **"L.N.K" sh.p.k, Tirane** për të realizuar pagesën sipas kërkesës suaj.


Deklarojmë gjithashtu se për çdo shtesë apo ndryshim i kushteve të kontratës për të cilën ju mund të bini dakord me kontraktuesin duhet të merrni paraprakisht dhe miratimin e garantuesit.

Kjo Certifikatë Garancie është e vlefshme deri më **06 Qershor 2009** dhe e rinovueshme në rast kerkese nga Autoriteti Kontraktor.

Lëshuar në Tirane, më **06 Dhjetor 2007**, në përputhje me Autorizimin nr. 2, datë 23.06.1999, pika 7, lëshuar nga Komisioni i Mbikqyrjes së Sigurimeve, mbështetur në dispozitat e Ligjit nr. 8081, datë 07.03.1996 "Mbi Veprimtarinë e Sigurimeve dhe Risigurimeve".

SIGURUESI

AVNI PONARI
Drejtor i Përgjithshëm



finance
central
europe

The Best Insurance Company
in Albania 2006

VENDIM
Nr.527, datë 23.4.2008

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.512, DATË 31.5.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT E KRYERJES SË KONTROLLIT TË NDIHMËS
EKONOMIKE, TË PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE SHËRBIMEVE
SHOQËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 27 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 7 të kreut II të vendimit nr.512, datë 31.5.2006 të Këshillit të Ministrave të shtohen pikat 8 e 9, me këtë përmbajtje:

“8. Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, në nivel qendror dhe rajonal, kontrollon saktësinë e informacionit, në këto institucione, në:

- a) zyrën e punës, për të vërtetuar nëse përfituesi është i punësuar/punëkërkues i papunë;
- b) zyrën e tatim-taksave, nëse janë subjekte të regjistruara në këto organe;
- c) zyrën e Inspektoratit Shtetëror të Punës, nëse nga aktet e inspektimit rezulton se janë punësuar informalisht;
- ç) zyrën e sigurimeve shoqërore, nëse përfiton pension pleqërie/familjar apo është kontribues në skemën e sigurimit vullnetar;
- d) zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nëse kanë në pronësi pasuri të paluajtshme;
- dh) zyrën e regjistrimit të automjeteve, nëse kanë mjete/automjete motorike;
- e) seksionet pranë bashkive/komunave si në atë të urbanistikës, të tregut të lirë, transportit, kulturës dhe energjetikës, nëse janë subjekte të regjistruara pranë tyre.

9. Kur Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, në nivel qendror dhe rajonal, vëren mospërputhje të informacionit të dërguar në njësinë e qeverisjes vendore me informacionin e kontrolluar në institucionet e përmendura në pikën 1, i paraqet drejtuesit të institucionit propozimin për marrjen e masave të mëposhtme për personat përgjegjës:

- a) gjobë, sipas neneve 5 e 6 të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”;
- b) vërejtje me shkrim;
- c) propozim për largim nga puna;
- ç) propozim për fillimin e procedurave nga autoriteti përgjegjës, në rastet kur mendohet se janë konsumuar elementet e veprës penale ose të kundërvajtjes penale.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.533, datë 1.5.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,

SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË ERSEKË TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Ersekë të qarkut të Korçës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Ersekë të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.353, datë 20.5.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Ersekë, të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Ersekë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Ersekë

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-11,493	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi
19-26,61	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
50-60,64	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social- kulturore e sportive	Në pronësi
98,99	Varrezat publike	Në pronësi
336-338,340-346,348-350, 352-371,383,385-394, 396-404,406,408,410,412, 415,416,418-420,423-427, 429,430,432-434,436-438, 441,442, 446-451,453-455, 457-460,462,463,465-469, 471-475,478-485	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
339,351,372-374,384,395, 405,407,409,411,413,414, 417,421,422,428,431,435, 440,443-445,452,456,461, 464,470,476, (duke përfshirë sipërfaqet e kthyer)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
32,63,128-139,141-335, 375-382,408,416,494	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
62	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
28-30,65-66,72-77,347	Prona që përdoren për ushtrimin e	Në pronësi

	funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	
79-97	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
42,43	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
46,47,48,477	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
31	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi

VENDIM
Nr.534, datë 1.5.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS UDENISHT TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Udenisht të qarkut të Korçës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Udenisht të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.15, datë 31.5.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Udenisht të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Udenisht për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Udenisht

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
7-13	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
1,	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi

5,21-25	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
26-28	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
14-20	Prona që përdoren në fushën kulturore sportive	Në pronësi
30-38	Shërbim funeral	Në pronësi
50-63,	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës. Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çfarëdo lloji	Në përdorim
232,233,238,239,244,245,248,249,252,253,254,259,260,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
234-237,240-243,246,247,250,251,255-258,261,266,270,278,285,289,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
64-92	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi

VENDIM
Nr.535, datë 1.5.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË PËRRENJAS TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Përrenjas të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Përrenjas të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.698, datë 19.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Përrenjas të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Përrenjas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Përrenjas

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-3	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi
4-7,9-16,346-394	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi

20,21,22,24	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
25-27,29-31	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social- kulturore e sportive	Në pronësi
32-41	Varrezat publike	Në pronësi
60-213,372,373,377, 379-383	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
3 17-345,374-376,385-444, 825,826,493-495	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
57-59	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
42-56	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
534,535,537,539-556, 565-824	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
5 16-522,536,538,557-564	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
384	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi
314-316	Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM

Nr.536, datë 1.5.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË Durrës TË QARKUT TË Durrësit

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Durrës të qarkut të Durrësit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 257 (dyqind e pesëdhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1840 (një mijë e tetëqind e dyzet).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Bashkia Durrës

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
25,55,56,26-29	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve administrative	Në pronësi
118,121,125,126,128, 129,130	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor	Në pronësi
137-175,1817,1821,1822	Prona që përdoren për realizimin e programeve	Në pronësi

	arsimore	
176-215,1823,1824,1835, 1836-1839,1840	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
1803, 1807,1809-1816	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
127,131,132,133,134,135, 136	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social- kulturore e sportive	Në pronësi
733-736	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale	Në pronësi
216-219,226-238,240- 732,1825-1831,1832-1834	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile	Në pronësi
737-806,814-821,828-869 870- 1059,1819,1820,1 147(vetëm pasuria 5/43)	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi
822-827	Varrezat publike	Në pronësi
1060-1146,1147(pa pasurinë 5/43)-1281	Troje dhe hapësira	Në përdorim
1286,1289,1293-1295, 1374-1377,1378-1398	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (kanale të treta, tokë inproduktive dhe objekte të ish-NB-ve)	Në pronësi
1290-1292, 1370-1373	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë produktive)	Në përdorim

VENDIM
Nr.538, datë 1.5.2008

PËR PËRCAKTIMIN E PAJISJEVE TË VEÇANTA, TË NGJYRAVE DHE SHENJAVE PËR MJETET E POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Policia e Shtetit përdor mjetet e saj lëvizëse, të uniformuara dhe të pauniformuara, të ndara në:

- a) mjete tokësore;
- b) mjete ujore;
- c) mjete ajrore.

2. Mjetet e uniformuara, në përdorim të strukturave dhe punonjësve të Policisë së Shtetit kanë:

- a) ngjyrë blu të errët;
- b) targën me fjalët “POLICIA” dhe numrin, në përputhje me kërkesat e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë;
- c) logon e Policisë së Shtetit, të vendosur në çdo anë të dukshme të mjetit, dhe numrin e telefonit;

ç) pajisjet sinjalizuese, ndriçuese e zanore (sirena).

Ngjyra, targat dhe logoja në mjetet e uniformuara të Policisë së Shtetit janë të njëjta.

3. Mjetet e pauniformuara, në përdorim të strukturave dhe punonjësve të Policisë së Shtetit, kanë logon dhe targën “POLICIA”, të lëvizshme.

4. Të gjitha mjetet e Policisë së Shtetit kanë pajisje të veçanta, të domosdoshme për sigurimin e jetës dhe realizimin e detyrës.

5. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit miraton:

- a) strukturat e Policisë së Shtetit, që do të përdorin mjete, të uniformuara dhe të pauniformuara

në funksion të detyrës;

b) llojet, sasinë dhe afatin e përdorimit të pajisjeve, që do të kenë mjetet e Policisë së Shtetit, sipas funksionit që ato do të përdoren;

c) rregulloren e përdorimit të mjeteve dhe të pajisjeve, për struktura të veçanta të Policisë së Shtetit.

6. Çdo akt nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 23.5.2008
Doli nga shtypi më 26.5.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 44 lekë